

V E N D I M
Nr. 603, datë 2.11.2001

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 479, DATË 31.8.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRGATITJEN DHE REALIZIMIN E KONTRATËS SË
KONCENSIONIT PËR NDËRTIMIN E TERMINALIT TË RI TË PASAGJERËVE NË
AEROPORTIN E RINASIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.479, datë 31.8.2000 të Këshillit të Ministrave bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 1 të shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Objekt i koncesionit të jenë edhe elementët e tjerë infrastrukturorë, shërbimet aeroportuale dhe joaeroportuale, sipas përcaktimit të masterplanit të zhvillimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Rinasit.”.

2. Në pikën 3 rreshti i parë, pas fjalëve “...të ri të pasagjerëve...”, të shtohen fjalët “dhe elementëve të tjerë infrastrukturorë, shërbimeve aeroportuale dhe joaeroportuale...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta